



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.953/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kimete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Suada Thaqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.953/2021, paraqitur nga Suada Thaqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në Vendvotimin VV 2001A/06D, VV 2006A/06D, VV 2006X/04D, në Komunën e Prizrenit.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet e vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga Suada Thaqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, për ti rinumëruar fletëvotimet në Vendvotimet VV 2006A/02R, VV 2042A/21R, VV 2042A/07.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.953/2021 të paraqitur nga Suada Thaqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, me te cilën pretendon se në vendvotimet VV 2001A/06D, 2006A/02R, VV 2042A/21R, VV 2042A/07R, VV 2006A/06D dhe VV 2006X/04D, në komunën e Prizrenit ka mospërputhje të votave dhe manipulim me vota, andaj ka kërkuar që të bëhet rinumërim në vendvotimet si në apel. Si dëshmi krahas apelit ka bashkangjitur Raportin e Vëzhguesit dhe Formularin e Rezultatit të Kandidatit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryera nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Suada Thaqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në VV2001A/06D, VV 2006A/06D, VV 2006X/04D dhe VV 2006A/02R, VV 2042A/21R, VV 2042A/07, sa i përket numrit të votave për kandidat, nga se rezulton se nga verifikimi i të dhënave zyrtare të ofruara nga KQZ rezulton se në vendvotimin VV2001A/06D kandidatja Suada Thaqi ka gjithsej tri vota derisa nga Raporti i Vëzhguesit i paraqitur si dëshmi krahas apelit vërehet se tek emri i kandidates në fjalë është i shënuar numri 9 ndërsa në formularin e Rezultatit të Kandidatit për Suada Thaqin janë të shënuara vetëm 3 vota, andaj qartë vërehen mospërputhje në numërimin e votave e për këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon

integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, pretendimet e saj mbeten vetëm ne suaza të dyshimeve. Pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.953/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.